

**INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR
I KREDISË KUFË (OVERDRAFT) PËR PAGAMARRES NE TB**

1. Emri dhe detajet e kontaktit të bankës

Banka Adresa Numri i Telefonit (*) Adresa e postës elektronike (*) Numri i Faksit (*) Adresa e Web-it	Tirana Bank <i>[Adresa gjeografike e bankës për t'u përdorur nga konsumatori]</i>
(*) ky informacion është opsional për Bankën	

2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

Lloji dhe përshkrimi i Produktit	Kredi Kufi (Overdraft) për Pagamarres pranë Tirana Bank (Paradhenie mbi Pagen). Ky produkt u ofrohet klienteve të cilët marrin pagën pranë Tirana Bank, punonjes të institucioneve publike dhe financiare apo të kompanive private.
Vlera totale e kredisë dhe monedha	Banka financon klientin me një limit deri në tre paga neto në vlera si më poshtë: Min: 10,000 LEK /100 EUR Max: deri në 3 (tre) paga neto
<i>(Nese eshte e aplikueshme)</i> Kredia është në monedhe të ndryshme nga ajo në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat.	Nuk Aplikohet
<i>(Nese eshte e aplikueshme)</i> Vlera e kesit të kredisë, e shprehur në monedhen në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, mund të ndryshojë.	Nuk Aplikohet
Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve	Disbursimi i kredisë bëhet i plotë në llogarinë e pages së kredimarrësit pranë Bankës
Këstet dhe tabela e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve)	Interesi përlllogarit me baze vjetore dhe paguhet në fund të çdo muaji. Interesi llogarit mbi shumën e përdorur dhe numrin e ditëve të përdorura. Principali mund të paguhet në çdo moment, i plotë ose pjesërisht sipas dëshirës së klientit apo sipas një shume të caktuar minimale të aprovuar. Huamarresi duhet të njohë mirë shumën totale të kesit mujor për të qenë i qartë nëse mund ta përballojë marrjen e një shume të kërkuar kredie. Shuma e kredisë 250,000 LEK Norma e Interesit 15% Periudha në shembull 1 vit Numri i kesteve 12

PERI UD HA	DATA E KËSTIT	NORMA INTERESIT	BALANCA E PRINCIPALIT	PRINCIPALI I PAGUAR	INTERESI	KËSTI	PRINCIPALI I MBETUR
			250,000	250,000			
1	19/09/2019	15.0%	250,000	19,440	3,125	22,565	230,560
2	19/10/2019	15.0%	230,560	19,683	2,882	22,565	210,878
3	19/11/2019	15.0%	210,878	19,929	2,636	22,565	190,949
4	19/12/2019	15.0%	190,949	20,178	2,387	22,565	170,772
5	19/01/2020	15.0%	170,772	20,430	2,135	22,565	150,342
6	19/02/2020	15.0%	150,342	20,685	1,879	22,565	129,656
7	19/03/2020	15.0%	129,656	20,944	1,621	22,565	108,712
8	19/04/2020	15.0%	108,712	21,206	1,359	22,565	87,507
9	19/05/2020	15.0%	87,507	21,471	1,094	22,565	66,036
10	19/06/2020	15.0%	66,036	21,739	825	22,565	44,297
11	19/07/2020	15.0%	44,297	22,011	554	22,565	22,286
12	19/08/2020	15.0%	22,286	22,286	279	22,565	0

* Tabela ilustrative për ripagimin e overdraftit.
Shembull i personalizuar i tabelës së amortizimit për kredinë e kërkuar I bashkëngjitet këtij material.

Shembull Kredie Kufi (Overdraft) për paguar në Tirana Bank	
Shuma e Kredise	250,000 LEK
Afati	12 Muaj
Norma vjetore e Interesit	15%
Totali i Interesave të Paguar	20,775 LEK
Totali i Kredise/Kestëve të Paguara	270,775 LEK

* Kosto të tjera të kredive të cilat duhen marrë parasysh vijojnë më poshtë.

Garanci të nevojshme	Nuk kërkohej garanci
----------------------	----------------------

3. Kostoja e kredisë

Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë.	LEK: TB 12M + 10%, Min 14% EUR: EURIBOR 12M + 12%, Min 15%
Norma efektive e interesit (NEI)	Norma efektive e interesit (NEI) përcakton koston totale që klienti do të përballojë për kredinë e marrë me kushtin që kredia do të shlyhet për periudhën e rënë dakort, palët i përmbahen kushteve të përcaktuara në kontratë dhe interesi dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara deri në fund të maturimit të kredisë. Norma efektive e interesit llogaritet duke marrë parasysh: <ul style="list-style-type: none"> - normën e interesit të overdraftit. - komisionin e administrimit prej 1.5%. - kohe zgjatjen e limitit të overdraftit prej 10 vjet Shembull i personalizuar NEI për kredinë e kërkuar i bashkëngjitet këtij material.
Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin që aplikohen të tilla.	Aplikohet Komision Administrimi 1.5% të shumës së kredise.
Kosto shtesë të tjera	Nuk aplikohen
Kostot në rastin e pagesave me vonesë	Tirana Bank penalizon vonesat në shlyerjen e kredisë. Në rast të mospagimit në kohe të kështit Banka aplikon një penaltet prej 25% mbi normën e interesit të aplikuar dhe llogaritja bëhet mbi shumën e papaguar dhe për periudhën në të cilën nuk është paguar detyrimi nga klienti. Penaltetet dhe kamatëvonesat të cilat paguhen nga kredimarrësi, nuk tejkalojnë në asnjë rast më shumë se 30 përqind të shumës së detyrimit kontraktor (këstit/kësëve të paguara të kredisë).

4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

Shlyerja para afatit të maturimit	0% komision për shlyerje të parakohshme
Mundësia e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit)	Nuk aplikohet

Produkte/sherbime shtese	Llogari page e lidhur me kredine; karte debit VISA
Informimi në rast refuzimi të kredisë	Banka informon konsumatorin, menjëherë, dhe pa komisione, nëse një aplikim për kredi është refuzuar, duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim.
Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës.	Mënyra e njoftimit dhe mënyra e marrjes së pëlqimit është me shkrim dhe është një nga pikat e kontratës së kredisë.
Skema e brendshme e ankimit të konsumatorit kundrejt bankës.	Ankese me shkrim pranë çdo dege të Tirana Bank pranë personave përgjegjës ose telefon 0800 68 68 ose 04-2277700 (nëse telefononi nga celulari ose jashtë vendit), 24 ore/7 dite të javës. Pranë çdo dege do të gjeni formularët e ankesave si dhe kutite perkatese të mbledhjes së ankesave.
Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.	Ky informacion është i vlefshëm prej datës.../.../.... deri në datën .../.../... 7 dite (kalendarike) nga data e marrjes në dorezim
<p>Banka, në zbatim të detyrimeve të saj ligjore dhe rregullatore, përditëson periodikisht këtë dokument të informacionit parakontraktor, me qëllim garantimin e transparencës së plotë ndaj klientit/konsumatorit. Në përputhje me Ligjin nr. 124/2024, datë 19.12.2024, 'Për mbrojtjen e të dhënave personale', si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Banka përpunon të dhënat personale të klientit/ konsumatorit vetëm për qëllime të vlerësimit të kërkesës për kredi, lidhjes dhe administrimit të kontratës së kredisë. Klienti/konsumatori, me marrjen e këtij dokumenti, jep pëlqimin e tij që të dhënat personale të mund të përpunohen dhe, kur kërkohet në mënyrë të ligjshme, të vihet në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës, në përputhje me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003, 'Për mbrojtjen e konkurrencës', të ndryshuar, për qëllime të vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së Bankës në treg nga ky Autoritet.</p> <p>Çdo përpunim, transmetim ose aksesim i të dhënave kryhet vetëm në masën e domosdoshme dhe në respekt të parimeve të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe konfidencialitetit.</p>	

Konsumatori
(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)

(Emër Mbiemër, Firma)